



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
ZYRA E PROKURIMIT



Shkresë	18.09.2023
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K.
Lënda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik në Kosovë, përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim në Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë:

VENDIM

1. Refuzohet kërkesa e operatorit ekonomik "Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K" kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES (B58) për projektin "Mirëmbajtja dhe zgjerimi i kamerave për institucionet e Komunës së Drenasit" me nr 611-23-8441-2-2-1 si e pabazuar. OE ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të AK-së me datën 16.09.2023 kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES (B58) të AK dhe refuzohet si e pabazuar për arsyjen si në vijim:

Lidhur me pretendimet e juaj të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim përgjigja e AK-së është: Sipas AK çmimet abnormal i ulët dhe për produktet që keni çekur në kërkesë nuk qëndrojnë dhe nuk ishte e nevojshme të kërkohen informacione shtesë lidhur me çmimet që ju keni pretenduar në kërkesë për rishqyrtim pasi si AK lejon konkurrencen sipas Udhëzimit Operativ dhe LPP-së. Ndërsa, lidhur me pikën tjetër tuaj në kërkesë ku keni thënë se "AK ka angazhuar komision vlerësimit jo profesionale", nuk jeni kompetent të bëni vlerësime të tilla dhe as të përziheni në çështjet që vendos AK për komisione. Komisioni është i përbërë nga njerëz profesionist të cilët e vlerësojnë në mënyrë profesionale sipas RRUOPP-së dhe LPP-së.

Kundër këtij vendimi keni të drejtë ankesë në OSHP në afate prej 10 dite.